



Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

06 Nr: 351-27204/24
Klinë, datë: 16.08.2024

PROCESVERBAL

Nga konsultimi publik për diskutimin e dokumentit të Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) për Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) Klinë 2024-2032, takimi i mbajtur me datë 02.08.2024 në Sallën e Kuvendit Komunal Klinë, më fillim në ora 14:00.

Prezantimi i këtij dokumenti para të pranishmëve është bërë me tabelë të mençur, gjithashtu është bërë edhe shpërndarja e materialit në formë fizike.

Mbledhjen e hapi drejtori i Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, z. Enver Berisha, i cila përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit, hapi diskutimin me këtë rend dite:

➤ Konsultim Publik i dokumentit të Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) për Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) Klinë 2024-2032

Drejtori i Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, z. Enver Berisha: Përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm. Të nderuar konsulent nga Kolegji UBT, Luljeta Ajdini, Shqiprim Ahmeti, Faruk Foniqi, Medina Shalaku. Faleminderit për pjesëmarrje. Po shqyrtojmë sot në konsultim publik dokumentit të Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) për Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) Klinë 2024-2032.

Sa i përket këtij dokumenti, qëllimi i raportit të VSM-së për Planin Zhvillimor Komunal të Klinës është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme që mund të rezultojnë nga zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal, si edhe të japë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikëpamja mjedisore.

Qëllimi kyç i raportit të VSM-së është analiza e gjendjes aktuale mjedisore për territorin e komunës së Klinës, në veçanti zonat në të cilat Projekt-PZHK ka përcaktuar zhvillime dhe



vlerësimi i ndikimit mjedisor të qëllimeve/strategjive të përcaktuara me projekt-PZHK-në. VSM-ja synon përmirësimin e planit duke sugjeruar objektiva apo strategji të reja, si dhe rishikimin e strategjive të propozuara dhe sugjeron përmirësimin e tyre në aspektin e mjedisit për të minimizuar ndikimet dhe rreziqet e mundshme. Ky raport duhet të lexohet së bashku me PZHK. Qëllimi përfundimtar i VSM-së është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe të kontribuoj në promovimin e qëndrueshmërisë.

Andaj, hapi diskutimin. Po urdhëro z. Dardan Bashota:

Diskutimi i parë - Dardan Bashota:

Stacionet e Monitorimit të Ajrit – Komuna e Klinës ka përpiluar Planin Lokal për Cilësinë e Ajrit – ende nuk është miratuar. Me atë plan është paraparë instalimi i 4 aparaturave (në secilin shesh nga 1 aparaturë).

Monitorimi i ujërave sipërfaqësor nuk është kompetencë e Komunës, MMPHI, Departamenti i Mjedisit dhe IHMK

Komuna ka të aprovuar Planin e Menaxhimit të Mbeturinave.

Ne parim niveli i ndotjes së ajrit ne Klinë është më I vogël në krahasim me komunat e tjera.

Përgjigja nga prezantuesit e VSM-së: Si koment është shumë pozitiv dhe njëkohësisht janë të nevojshme këto aparatura në lokacionet që ju përmendet nga se në çdo moment jemi të informuar mbi cilësinë e ajrit dhe shkaqet e ndotjes. Po ashtu, VSM do të i ndihmojë shumë në zhvillimin e këtij plani të cilin e përmendi z. Bashota.

Diskutimi i dytë - Vlora Tafili:

Pyetja: Cili mund të jetë ndikimi në mjedis i zhvillimit të Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore?

Përgjigja nga prezantuesit e VSM-së: Zhvillimi duhet të bëhet në përputhje me praktikën me të mira të ruajtjes së mjedisit. Duke u fokusuar në sigurimin e balancimit mes zhvillimit dhe ruajtjes së mjedisit.

Është paraparë zhvillimi i agro-turizmit me fokus të veçantë në Eko-Turizmin. Në këtë mënyrë edhe do të mund të zhvillohet bujqësia, edhe mund të mbrohet natyra, burimet ujore dhe cilësia e ajrit.

Drejtori i Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, z. Enver Berisha: Ju faleminderit parafolës. Nëse dikush tjetër dëshiron të shtojë diçka, urdhëroni;



Nëse, jo, atëherë unë po e mbyll takimin, po njëkohësisht shtojë se konsultimi publik do të zgjasë deri më 15 gusht 2024, andaj ka ende kohë në mënyrë fizike apo me email që ti dërgojë komentet apo kërkesat.

Ju faleminderit.

Të bashkëngjitur: Listën e pjesëmarrësve në debat publik.

Takimi u mbyll në ora 14:47.

**Procesmbajtësja,
Antonije Selmanaj**



**Drejtori i DUMM,
Enver Berisha**



|
|
|

|
|
|